



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV-të
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 106/13
Prishtinë, më 08.05.2013, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Duda Balje, Sali Asllanaj, Sevdije Lama, Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Latif Gashi dhe Hykmete Bajrami.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Sabrije Saliuki – Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Halit Gara, Enis Berisha dhe Gëzim Qerimi nga ARH, Ruzhdi Jashari-Bujar Sadiku nga ASHMDHP, Hasan Preteni, Fidan Musliu dhe Bedri Mecini-AKK.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 26.04.2013, 29.04.2013 dhe 02.05.2013;
3. Shqyrtimi i Raporti financiar vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2012;
4. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2012;
5. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2012;
6. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Zyrës Rregullative për Energji për vitin 2012;
7. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Hetimor Parlamentar për lejimin e mjeteve buxhetore;
8. Shqyrtimi i Projektligji nr.04/L-181 për produktet e ndërtimit me amendamentet e komisionit funksional;
9. Shqyrtimi i Projektligji nr.04/L-187 për treguesit gjeografik me amendamentet e komisionit funksional;
10. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja propozoj që pika e gjashtë dhe e shtatë të rendit të ditës të shtyhet për një takim tjetër.

Miratohet rendi i ditës, me ndryshime, pa pikën gjashtë dhe shtatë, që shtyhen për shqyrtim në një takim tjetër të komisionit.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 26.04.2013, 29.04.2013 dhe 02.05.2013

Kryetarja konstatoj se procesverbalet miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raporti financiar vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2012

Kryetarja sqaroj se në mbledhjen e fundit është shqyrtuar Raporti Financiar vjetor të ARH-së. Mirëpo në bazë të formularëve kemi vërejtur se tek shërbimet kontraktuese kanë qenë mjete të shpenzuara por nuk kanë qenë të miratuara. Nga përfaqësuesit nuk kemi pas mundësi të marrim informata se ku janë shpenzuar 11,984 €. Në krahasim me shumatat e planifikuara mjetet kanë shënuar rritje ku një pjesë e tyre janë transferuar nga shpenzimet kapitale.

Halit Gara theksoj se viti 2012 për ARH-në ka qenë mjaft dinamik sa i përket aktiviteteve organizuese. Buxheti fillestar për vitin 2012 ka qenë 211,510 €, ndërsa në kategorinë *Paga dhe Mëditje* 101,447 €, *Mallra dhe Shërbime* 76,013 €, *Shpenzimet publike* 14,000 €. Në afatet ligjore kemi bërë një kërkesë për rishikim të buxhetit dhe kemi arrit mirëkuptim. Buxheti pas rishikimit është 243,362 € kurse është shpenzuar 225,419 €. ARH-ja ka pasur suksese në vitin 2012, kemi filluar përmbushjen e misionit kryesor. Të gjitha shpenzimet janë në përputhje me ligjin për menaxhimin e financave publike, të gjitha kërkesat janë të realizuara me kohë.

Kryetarja kërkoj sqarim për shpenzimet kontraktuese të cilat nuk kanë qenë të planifikuara.

Halit Gara sqaroj se ka pasur ndryshime në vitin 2012, shpenzimet lidhen me atë se janë themeluar departamente të reja, kanë lindur kërkesa të reja, vizitat që janë bërë, pastaj planifikimi i investimeve të reja në sektor.

Xhevdet Neziraj pres në mënyrë të detalizuar përgjigjen e shpenzimit të buxhetit.

Halit Gara theksoj se është një formular unik i plotësuar.

Kryetarja sqaroj se Komisioni shikon rrjedhën e shpenzimeve të të gjitha institucioneve dhe vërejmë se sa është realizuar ajo që është planifikuar. Shpenzimet për *Mallra dhe Shërbime* janë realizuar 99,9 % por tek shërbimet kontraktuese nuk kemi pas planifikim.

Enis Berisha sqaroj se shpenzimi është bërë 99,99% sepse 13,000 € kemi mbet borxh për shërbime tjera. *Shërbimet publike* kanë pasur buxhet të aprovuar 14,000 € kurse me rishikim 6,000 € prej të cilave janë shpenzuar 5,859 €. Para rishikimit është dashur që punëtorët të kenë kontratë në vepër.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit miratimin e Raporti vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2012.

4. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2012

Kryetarja konstaton se në bazë të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, agjencia duhet ti raportojë Kuvendit, së bashku me raportin financiar sipas formularëve të përgaditur nga KBF. Buxheti i ndarë është në vlerë prej 274,000 € kurse me rishikim janë ndarë edhe 26,000 €. Buxheti i realizuar është 94 %, mirëpo shpenzimet për *Investime kapitale* janë shpenzuar 90 %, për *Paga dhe Mëditje* 93 %, *Mallra dhe Shërbime* 96%.

Ruzhdi Jashari theksoj se tashmë Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale konsiderohet institucion i besueshëm nga institucionet e BE-së, ku pritët të marrim pjesë në një konferencë të organizuar. Prezentoj shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe nivelin e shpenzimeve.

Naser Osmani konsideroj se është shumë e rëndësishme çështja e operimit të buxhetit, por shpreh mendimin se ky raport nuk është i bazuar në të dhëna konkrete, të sakta, sepse kemi vetëm shuma absolute. Në raporte duhet të vendoset vlera e saktë e shpenzimeve.

Bujar Sadiku sqarohet se sa i përket mënyrës së barazimit të shumave është një formë e kontabilitetit ku kërkohet nga Ministria e Financave, edhe nga raportet e tjera që i kemi bërë. Në kuadër të Raporteve të free-balancit, raportet nxjerren standarde por kur barazohen si shuma-qindëshet dhe dhjetëshet nuk dalin. Në nivelin tonë momental të zyrtarëve kemi raportuar në tre nivele: në MF, në Raportin vjetor dhe në Raportin e kërkuar nga Komisioni. Këtë vit ka qenë e pamundur detajizimi i raportit.

Kryetarja theksoj se tek *Shpenzimet Komunale* është realizuar buxheti 100%, tek *Mallrat dhe Shërbimet-shpenzimet e udhëtimit* 82%, *Shpenzimet e telefonisë mobile 1111-* 100%. Ky nuk është raport i plotësuar në pajtim me formularët e komisionit. Çështja e barazimit me MF është çështje tjetër.

Bujar Sadiku sqarohet se nuk kemi as zyrtarë kryesor financiar as zyrtarë financiar, mundësia e vetme e raportimit ka qenë kjo, por Ministria e Financave në bazë të rregullorës së saj kërkon formë dhe udhëzim që në formë të kontabilitetit raportet të barazohen.

Naser Osmani mendon se kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për raportim sepse nuk mund të jenë raporte të tilla të supozuara.

Sali Asllanaj konsideroj se duhet të i'u jepet një afat kohor për përpilimin e raportit financiar më të detalizuar.

Kryetarja kërkon nga përfaqësuesit e Agjencisë që në takimin tjetër të vijjnë me raport të detajuar.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Shtyhet shqyrtimi i raportit të ASHMDHP-së për takimin tjetër, dhe kërkohet nga Agjencia plotësimin e raportit financiar me të dhëna të detalizuara të planifikimit dhe shpenzimit në pajtim me formularët e hartuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa

5. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2012

Kryetarja sqaroi se raportit financiar tregon se buxheti i shpenzuar është 93%.

Hasan Preteni theksoj se ka përmirësim në pjesën logjistike të Agjencisë, vitin e kaluar kemi pasur buxhet të mjaftueshëm, nuk kemi pas kërkesa të veçanta. Kemi kërkuar që të sigurohet një bazë më e dinjitetshme për zyrtarët. Nuk kemi shpenzim, investimet që i kemi pasur i kemi realizuar, 4 vetura janë blerë vitin e kaluar. Sa i përket *Mallrave dhe Shërbimeve* gjithçka është në rregull. Një kërkesë e jona është ngjarje përmes të cilës dëmtohet pavarësia e Agjencisë, është vendim i Ministrisë që paguan qiranë Kishës Ortodokse për agjencinë. Është bërë keqinterpretim i kërkesës por është dëshmuar që objekti në të cilin është agjencia nuk i përket Kishës ortodokse, kemi siguruar vendime me dokumentin valid në Serbi, mendoj se është gjendje alarmante- të merret parasysht.

Kryetarja tek çështja e mbajtjes së stafit, duhet me mendu se secili institucion ju ofron trajnime, përgatitje stafit të vetë dhe në një farë mënyre ti kushtëzoj që ti shërben atij institucioni për një kohë të caktuar.

Bedri Mecini unë pas një analize të zyrës së personelit, kam konstatuar që dymbëdhjetë zyrtarë kanë kaluar në institucione të tjera, prej tyre pesë janë drejtorë të departamentesh dhe pesë menaxher të divizioneve. Fatkeqësisht, po vërtetohet ajo që pas një trajnimit dhe pas titujve shkencor, po largohen në institucione tjera, ku e vetmja arsye është se ofrojnë kushte më të mira. Mirëpo puna e agjencisë ka vazhduar e suksesshme, të gjitha ato pozita janë zëvendësuar nga stafi i brendshëm, pas një verifikimi të brendshëm dhe sipas meritave.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit miratimin e Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2012.

6. Shqyrtimi i Projektligji nr.04/L-181 për produktet e ndërtimit me amendamentet e komisionit funksional

Kryetarja në bazë të analizave është kuptuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara nga komisioni funksional nuk përmbajn implikime buxhetore shtesë.

Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

Projektligji nr.04/L-181 për produktet e ndërtimit me amendamentet e komisionit funksional, nuk përmbajn implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Projektligji nr.04/L-187 për treguesit gjeografik me amendamentet e komisionit funksional

Kryetarja në bazë të analizave është kuptuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara nga komisioni funksional nuk përmbajn implikime buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.04/L-187 për treguesit gjeografik me amendamentet e komisionit funksional, nuk përmbajn implikime buxhetore shtesë.

8. Të ndryshme.

8.1. Kryetarja theksoj se kur kemi hartuar planin e punës për këtë vit, kemi paraparë që si çështje me të cilën do të angazhohemi në këtë vit ka qenë transparenca buxhetore dhe në bashkëpunim me GIZ është planifikuar që diku me 10-14 Qershor të bëjmë një vizitë në Gjermani. Është menduar që në këtë kohë fokusimi jonë do të jetë të transparenca buxhetore, si i qaset Budestagu, po ashtu është paraparë të vizitohet edhe një vend tjetër është menduar Landi i Hamburgut, sepse në Hamburg e kishin nxjerrë një ligj shumë të mirë për transparencën dhe do të jetë në interes për neve.

Lukas Fischer njoftoj për përgatitjen dhe organizimin që po bënë GIZ-ja për vizitën studimore për komisionin që do të ndodh në muajin qershor në Berlin dhe Hamburg. Shumë shpejtë do të finalizohet agenda dhe detajet tjera për vizitën. Vizita po përgaditet për të gjithë anëtarët e komisionit.

8.2. Kryetarja njoftoi se Gjykata Kushtetuese përmes aktgjykimit ka anuluar disa nene të Ligjit për Bankat dhe Institucionet mikrofinanciar dhe Institucionet e tjera financiar dhe mendojm që ne si komision mos të rrijmë të heshtur para kësaj dhe të fillojmë iniciativën çfarë të bëjmë në këtë drejtim nga se e dimë që aty është një problem i pazgjedhur. Prandaj në një takim të ardhshëm ti ftojmë Ministrin e Shërbimeve Publike sepse për të rregulluar këtë çështje së pari duhet të fillohet iniciativa tek Ministria e Shërbimeve Publike, tek ligji për OJQ-të. Është jashtë logjikës që një institucion mikrofinanciar që krijon profit të jetë me status të OJQ-së dhe ta ftojme ministrin e financave dhe Guvernatorin e Bankës Qendrore .

Mbledhja përfundoi: 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit

Safete HADERGJONAJ